VENDIM
Nr. 1081, datë 18.12.2013

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT NDËRINSTITUCIONAL PËR BASHKËRENDIMIN E PUNËS NË ZBATIMIN E PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 116/2013 "Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP), dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)", të ligjit nr. 104/2013 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë, për projektin për Gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP)", dhe të nenit 4 të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Komisionit Ndërinstitucional për bashkërendimin e punës në zbatimin e projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik Pipeline (TAP), i emërtuar "Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP".

2. Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP kryesohet nga ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- Zëvendësministrin e Energjisë dhe Industrisë;
- Zëvendësministrin e Punëve të Brendshme;
- Zëvendësministrin e Financave;
- Zëvendësministrin e Drejtësisë;
- Zëvendësministrin e Mjedisit;
- Zëvendësministrin e Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
- Zëvendësministrin e Transportit dhe Infrastrukturës;
- Zëvendësministrin e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- Zëvendësministrin e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
- Drejtorin e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë;
- Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Doganave;
- Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve;
- Zëvendëskryeregjistruesin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

3. Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP ka këto përgjegjësi dhe detyra:

a) Bashkërendimin e punës në zbatimin e detyrimeve kontraktore të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me parashikimet e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik, dhe marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë, për projektin për Gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP), të ratifikuara nga Kuvendi.

b) Bashkërendimin ndërministror të punës për formulimin e qëndrimeve që do t'i paraqiten për trajtim dhe/ose vendimmarrje Këshillit të Ministrave dhe, sipas rastit, Kuvendit, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik, dhe marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë, për projektin për Gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP), të ratifikuara nga Kuvendi.

c) Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës me institucionet e pavarura dhe/ose entet

rregullatore të Republikës së Shqipërisë, që kanë detyra ose janë përgjegjëse për zbatimin e detyrave në realizimin e projektit TAP, në kuadër të marrëveshjeve të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi.

ç) Përcaktimin e detyrave për institucionet dhe subjektet e varësisë të ministrive dhe kontrollin e zbatimit të tyre.

4. Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP mblidhet çdo 3 (tre) muaj ose në çdo kohë, me kërkesë të kryetarit.

5. Në mbledhjet e Komisionit Ndërinstitucional për Projektin TAP mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësues të organeve të qeverisjes vendore dhe të institucioneve të tjera të interesuara, kur çmohet se pjesëmarrja e tyre do të jetë e vlefshme për përmbushjen e misionit të bashkërendimit të punës në zbatimin e projektit TAP.

6. Kryetari i Komisionit Ndërinstitucional për Projektin TAP i raporton Kryeministrit për ecurinë e realizimit të projektit TAP, problematikat e hasura, masat e ndërmarra dhe rezultatet konkrete të arritura, si dhe për çështje të veçanta.

7. Komisioni Ndërinstitucional për Projektin TAP ndihmohet nga sekretariati teknik, i cili ka këto detyra kryesore:

- përgatitjen e takimeve të këtij Komisioni;
- raportimin periodik në mbledhjet e këtij Komisioni mbi realizimin e detyrave të përcaktuara në mbledhjet e mëparshme ose që janë në zbatim të marrëveshjeve, të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi;
- bashkërendimin e punës ndërmjet institucioneve për zbatimin e detyrave të këtij Komisioni, si dhe monitorimin e zbatimit të këtyre detyrave;
- bashkërendimin e punës me shoqërinë TAP AG për aspektet e ndryshme të plotësimit të detyrimeve të Republikës së Shqipërisë, që lindin nga marrëveshjet e përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi;
- mbështetjen e shoqërisë TAP AG në proceset dhe marrëdhëniet me institucionet që janë të përfaqësuara në këtë Komision;
- kryerjen e detyrave të tjera që përcaktohen nga kryetari i këtij Komisioni.

8. Përbërja, mënyra e funksionimit dhe detyrat e hollësishme të sekretariatit teknik përcaktohen me urdhër të ministrit të Energjisë dhe Industrisë.

9. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe institucionet e përfaqësuara në Komisionin Ndërinstitucional për Projektin TAP për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama